



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

P.nr.805/2017

Më
Dana

26-03-2018

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ - Departamenti i Pergjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtarin ligjor procesmbajtës Blend Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR], nga Ferizaj, rruga "[REDAKTUAR]", për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.200-3/2017 e dt. 30.03.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Valdet Avdiu, i dëmtuari [REDAKTUAR] së bashku me përfaqësuesin ligjor prindin [REDAKTUAR] me dt.14.02.2018, solli dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rruga "[REDAKTUAR]", i lindur me [REDAKTUAR], në Prishtinë, nga i ati [REDAKTUAR] e ëma [REDAKTUAR] e gjinis [REDAKTUAR] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, babë i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa dënuar deri më tani, mbrohet në liri me numër personal [REDAKTUAR]

ËSHTË FAJTORË

SEPSE:

- me datë 19.01.2017, rreth orës 15:00, në oborrin e shkollës fillore "Jeronim De Rada", në rrugën "Dëshmorët e Kombit", në Feriza, i mllefosur për shkak se i mitur, i dëmtuar [REDAKTUAR], duke lozur me topa bore me shkët e tij aksidentalisht e godet me bore në ftyrë, i pandehuri me dashje që ti shkakton lëndime trupore e godet disa here me shuplaka në ftyrë dhe kokë, të dëmtuarin e lartë cekur me ç'rast i njëjti pëson lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme të shëndetit,-

-Me të cilën ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par 1.4 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së të akuzuarin e

G J Y K O N ME DËNIM ME GJOBË

I.Të akuzuarit [REDAKTUAR], i shqipton dënimin mr gjobë në shumë prej 200 /dyqindë/ Euro, të cilin dënim me gjobë, nga rrethanat e arsyeshme i mundëson ta paguan me këste për një priudhë prej katër muajëve, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

II. Të dëmtuarin [REDAKTUAR] përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit, prindi [REDAKTUAR] me vendbanim në Ferizaj rruga e [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

III. Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale për ekspertizën mjeko- ligjore shumë prej 20 Euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 (njëzetë)

€uro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbartimit të dhunshëm

IV. I shqiptohet taksa në shumën prej 30 €uro, konform nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.200-3/2017 e dt. 30.03.2017, me të cilën ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR], nga Ferizaj, rruga " [REDAKTUAR] ", për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt. 14.02.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Valdet Avdiu, i dëmtuari [REDAKTUAR] së bashku me përfaqësuesin ligjor prindin [REDAKTUAR] dhe i akuzuari [REDAKTUAR]

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të dërgjatat e të akuzuarit janë rerspektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar atakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari [REDAKTUAR], në shqyrtimin fillestar, ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar ku ka theksuar se është e vërtetë se ditën për të cilën akuzohet ka shkuar në shkollën " Jeronim De Rada " në Ferizaj me qëllim që të dërgoj djalin në shkollë dhe marrjes së vajzës nga shkolla, me të arritur në oborrin e shkollës disa nxënës ishin duke lozur me topa bore dhe pa pritur është goditur nga i dëmtuari me një top bore në sy dhe nga ai moment ka qenë shumë i mllëfosur dhe direkt është drejtuar nga [REDAKTUAR] i cili është këtu në seancë gjyqësore dhe nga dhimbjet që ka marrë në sy nga ky boks i borës pranon se e ka goditur njëher me shuplakë në faqen e majtë, dhe nga ky rast ka shkuar në shollë që të takohet me drejtoreshën e shkollës për ta njoftuar me këtë rast por e ka njoftua se është njoftuar nga prindi i të dëmtuarit i ka thënë se ai nuk ka nevoj që të takohet me te, i kërkon falje të dëmtuarit dhe prindit të tij, pendohet për veprën e kryer, ka premtuar se më nuk do të përsëris këso veprime dhe gjithëher do të jet më i kujdesshëm, ka kërkuar nga gjykata që gjatë shqyrtimit të sanksionit penal të ketë parasysh pranimin e fajësisë pendimin për verën e kryer.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, dhe të dëmtuarit [REDAKTUAR] përfaqësuesin ligjor prindin [REDAKTUAR]

Prokurori i shtetit Valdet Avdiu deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi pranimi i tillë është bërë konform ligjit gjegjësisht në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit dhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës e të cilat e vërtetojnë

gjendjen faktikei porpozon gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merrë për bazë pranimin e fajsisë

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit, prindi [REDAKTUAR], në shqyrtimin fillestar pajtohet me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit në këtë fazë të procedurës penale dhe ka kërkuar që gjykata ta shpallë fajtor për veprës penale që është i akuzuar dhe mbetet pranë kërkesës pasurore juridike.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i akuzuari pranimin e fajsisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale në konstatimin dhe mendimin e kespertit të mjeksisë ligjore e dr. [REDAKTUAR] të dt. 15.03.2017, lidhur me lëndimet që ka pësuar i dëmtuari [REDAKTUAR], deklarata e të dëmtuarit- të miturit dhën në polici me dt.01.02.2017 deklarata e të pandehurit dhën në Staacioni e Policisë në Ferizaj me datën 31.01.2017.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjithë elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par 1.4 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasyshtë të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojinë dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajsisë nga ana e të njëjtit, pendimin për veprën penale të kryer, kërkim falje shprehur të dëmtuarit dhe prindit të tijë, baba i tre fëmijëve, gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjesisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej 200 /dyqindë/ Euro, nga rrethanat e arsyeshme i mundëson ta paguan me këste për një priudhë prej katër muajëve, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, si në dispozitiv duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.


Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së i dëmtuari- përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit [REDAKTUAR], prindi [REDAKTUAR] me vendbanim në Ferizaj rruga e " [REDAKTUAR] ", për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nënpar. 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e viktmave të krimit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.805/17 me datë 14.02.2018

Zyrtari Ligjor
Blend Rexhepi

Gjyqtari
Adem Shabani


KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.